



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE**

Nr. 29 Prot

Tiranë më, 30/06/2021

VENDIM

“Për hapje procesi regjistrimi për rektor dhe anëtar Senati”

Bazuar në ligjin nr. 8485, dt. 12.05. 1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 131 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 173, datë 22.06.2021 “Për procesin zgjedhor për autoritetet drejtuese në Akademinë e Studimeve Albanologjike”, urdhrin e Rektorit të Akademisë së Studimeve Albanologjike Nr. 223/1 Prot, datë 24.06.2021, vendimin e Senatit Akademik të Akademisë së Studimeve Albanologjike Nr.4, datë 28.06.2021 dhe të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike”, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 30.06.2021:

VENDOSI

1. Hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Rektor të ASA.
2. Hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për anëtar të Senatit Akademik të ASA.
3. Hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve, për përzgjedhjen e përfaqësuesit të studentëve si anëtar të Senatit Akademik të ASA-së.
4. Afati për dorëzimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e kandidatëve është nga data 30.06.2021- 04.07.2021 edhe online në adresën info@asa.edu.al
5. Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet pranë sekretares së KIZ, znj.Blerina Kuqi, nga ora 08-16.00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Hasan Bello



AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

www.asa.edu.al || info@asa.edu.al || tel.: (+) 2240713

Sheshi “Nënë Tereza”, Nr. 3, Tirana - Albania



Academy for Albanian Studies

Archeology, History, Anthropology & Arts, Linguistics & Literature


Sheshi “Nënë Tereza”, Nr. 3, Tirana - Albania

ANËTARË:


Ervin Kaçiu



Nevila Molla



Erjena Lamaj



Ervin Kujtila



SEKRETARE

Blerina Kuqi

